

Reflektim mbi rrugëtimin deri në parlamentin e tretë rural të vendit

Kanë kaluar tashmë gati tetë vite që nga themelimi i Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural, me synim promovimin e qasjes LEADER në vendin tonë duke u fokusuar në mbështetjen dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve publik dhe privat në zonat rurale, në ndërtimin e partneriteteve në funksion të ngritjes së Grupeve Vendore të Veprimit (GVV), si edhe në rritjen e besimit të shoqërisë rurale për të ecur në rrjedhën e politikave dhe praktikave evropiane të zhvillimit të qëndrueshëm.

Njëherazi, ANRD ka mbështetur advokimin kombëtar për politika mbështetëse dhe inkurajuese për zhvillimin e qasjes LEADER, por edhe politika dhe skema financiare mbështetëse për fermerët dhe aktorët e tjerë të angazhuar, për të sjellë besim dhe nxitur aktivizimin e tyre në këtë rrugë. Mbështetja e kapitalit social ka qenë dhe mbetet prioritet për ANRD-në.

Parlamenti rural shqiptar është një përpjekje edhe më e fokusuar në drejtim të fuqizimit të grupeve të rëndësishme shoqërore, dhe pikërisht ngrihet mbi dy shtylla të rëndësishme për jetën rurale dhe qasjen LEADER, atë të Qendrës së Rinisë Rurale dhe mbështetjen e nismës së Pro-Grave Rurale.

Parlamenti i tretë rural në vend vjen në një kohë, që falë edhe advokacisë nga poshtë, kur Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin për Grupet Vendore të Veprimit duke krijuar një mundësi reale për të zhvilluar partneritete për fuqizimin e bashkëpunimeve vendore për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Por, përgatitja e aktorëve vendorë, njësive të vet-qeverisjes vendore, biznesit dhe shoqërisë civile ende është larg një investimi të qëndrueshëm për të rritur besimin e aktorëve për t'u bërë bashkë për ndryshim. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të bëjë më tepër për të hapur proceset ndaj aktorëve të shoqërisë dhe të rrisë këtë bashkëpunim. Mbështetja e fermerëve apo sipërmarrjeve turistike rurale duhet të shoqërohet me ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore duke i vlerësuar, le të themi "bujtinat" si instrument cilësor për fuqizimin e Grupeve Vendore të Veprimit të zonës. Kjo kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm, duke qenë se është investim në kapitalin njerëzor.

ANRD vjen në këtë ngjarje kombëtare më e konsoliduar, me një trend rritës të anëtarësisë dhe një aktivitet që kalon kufinj të vendit. Rrjeti është i shtrirë në të gjithë vendin, dhe ka raporte bashkëpunimi me të gjithë njësitë e vet-qeverisjes vendore. Synim në vazhdimësi mbetet konsolidimi i Rrjetit Kombëtar për Zhvillimin Rural si qendër burimore për zhvillimin e qëndrueshëm rural të vendit dhe zbatimin e qasjes LEADER.

Me kënaqësi evidentojmë se ANRD ka rritur praninë e saj në shumë organizata dhe aktivitete evropiane. Njëkohësisht është vlerësuar me çmime të ndryshme, një ndër të cilët është Flamuri i Gjelbër (Green Flag) CIA Agricoltori Italiani, duke dëshmuar punën e vet të bërë ndër vite në sektorin e fuqizimit të shoqërisë civile dhe zhvillimit rural në Shqipëri.

Rrjeti tashmë është tërësisht i pavarur sa i takon anës administrative dhe udhëheq projekte rajonale të financuara nga BE dhe jo vetëm.

Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural është duke zgjeruar dhe bashkëpunon edhe me institucionet publike në vend. Krahas bashkëpunimit shumë të mirë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është rritur komunikimi edhe me Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, një ngjarje shumë e rëndësishme për impaktin e punës së Rrjetit.

Univesiteti Bujqësor i Tiranës mbetet partneri ynë kryesor, jo thjesht për hapësirë fizike të mjediseve të tij që si gjithmonë ndahen me dashamirësi, por edhe për mbështetjen dhe këshillimin e vazhdueshëm në punën tonë.

Në përfundim, më lejoni të falenderoj të gjithë donatorët që kanë mbështetur Rrjetin Kombëtar për Zhvillimin Rural në këto vite, bashkëpunëtorët tanë kudo në vend, dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet të përbashkët dhe të rëndësishëm për të gjithë.

Sotiraq Hroni

Kryetar Bordi

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural